



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

3864
Nr. _____ Prot.

Date 15.10.2010.

Adresa : Rruga " Haxhi Hysen Dalliu " Nr.18/1

Tel/fax :++355 42 59 808.

L E N D A : Dergohet vendimi i mosfillimit.

FORUMI MUSLIMAN I SHQIPERISE

Z.FISNIK KRUJA

Adresa: RRUGA "Sami Frasheri".

T I R A N E

Bashkelidhur ju dergojme vendimin e mosfillimit dt 18.07.2010, per kallzimin penal nr.3864 te vitit 2010.

DREJTUESI I PROKURORISE

SOKOL MALAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

V E N D I M
PER MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL NR.3863/2010

Ne, Tirane, sot me dt, 18.07.2010.

Une, **Arben Qosja**, me detyre prokuror ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi studiova aktet e materialit kallzues nr.3864 te vitit 2010 si dhe materialin e kallzuar nga Komuniteti Mysliman i Shqiperise me nr.3613prot dt 31.05.2010:

K O N S T A T O V A

Me dt, 18.06.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, ka regjistruar materialin kallzues nr.3864, ardhur nga Forumi Mysliman i Shqiperise, perfaqesuar nga kryetari Fisnik Kruja, dhe materiali kallzues nr.3613prot dt 31.05.2010 i Komunitetit Mysliman te Shqiperise, perfaqesuar nga kryetari Z.Selim Muça,ku kerkohet rregjistrimi i procedimit penal, per veprat penale "Nxitja e urretjes ose grindjeve ndermjet kombesive, racave dhe feve", "Thirrja per urrejtje nacionale" dhe "Perhapja e informatave te rreme qe ngjallin panik", parashikuar nga nenet 265,266 e 267 te K.Penal, kunder shtetasit Kastriot Myftaraj, me detyre gazetar ne gazeten "SOT".

Objekt i kallzimeve penale jane shkrimet(artikujt) me tituj "Ylli i kuq i Moskes dhe Guri i Zi i Mekes"i dt 27.05.2010, dhe "Nje formule per matjen e shkalles se rrezikut te terrorizmit islamik ne Shqiperi dhe Kosove", dt 28.05.2010, me autor shtetasin Kastriot Myftaraj.Te dyja artikujt jane botuara ne gazeten e perditeshme "SOT".

Ne artikullin me titull "*Ylli i kuq i Moskes dhe Guri i Zi i Mekes*" autori Kastriot Myftaraj vec te tjerash shkruan "*..Eshte absurde qe edhe sot te kete shqiptare, per fat te mire nje pakice tek kombi shqiptare ne dy anet e kufirit, te cilet ende besojne tek nje fe si islami....Islami prish koherencen nacionale*

shqiptare.....muslimani praktikant nuk e quan veten shqiptar musliman, por musliman shqiptare....Per mua muslimani shqiptare eshte armiku, me te nuk kam cte diskutoj, dhe me te as mund te diskutohet....Ai shfaq nje barbari te thelle.Une e urrej ate se ai eshte bartes i nje feje qe shfaq hapur armiqesine ndaj kombit shqiptare....Ne duhet te ndahemi me Islamin me ane te nje referendumi mbarekombetare..."

Ne artikullim me titull **"Nje formule per matjen e shkalles se rrezikut te terrorizmit islamik ne Shqiperi dhe Kosove"**, dt 28.05.2010, autori Kastriot Myftaraj shkruan *"...shkurt eshte e nevojshme nje lufte preventive kunder radikalizmit islamik ne Shqiperi....Menyra me efikase per zhvillimin e kesaj lufte eshte nxjerrja jashte ligjit e fese islame ne Shqiperi dhe mbyllja e te gjitha objekteve te saj te kultit...."*.


Ne artikullin e dt 02.06.2010 me titull **"Kur Lehja e qenit ndaj henes quhet fe"**, nder te tjera shkruan *"...qenlehja eshte fe legale ne Shqiperi, dhe ne krejt trojet shqiptare ne dy anet e kufirit.Provat per kete i keni pese here ditën edhe naten, kur ne te gjithë qytetet dhe fshatrat e shqiperise rreth dhjete mije megafona te vendosur ne 2000 minare lehin arabisht...."*.

Ne artikullin e dt 05.06.2010 me titull **"Shqiperia natyrale e mikut tim Koco Danaj, ose ulu muhamet te bejme muhabet"**, nder te tjera shkruan *"....Rindertimi i dimensionit kulturor te Shqiperise Natyrale eshte nje proces i veshtire dhe qe kerkon kohe.Por ajo qe eshte imediate, duhet qe te zhbehet demtimi qe u be ne dimensionin kulturor te Shqiperise natyrale, ne Shpirtin shqiptare.Kjo mund te behet lehte dhe thjesht me deislamizimin e trojeve shqipatre ne dy anet e kufirit...kam parasysh mbylljen e xhamive dhe ndalimin e Islamit ne hapesiren shqiptare, me ane te nje referendumi nacional...."*

Per kete sipas kallzuesit ka pergjegjesi ligjore z.Selim Muça, Kryetar i Komunitetit Mysliman ne Shqiperi, dhe Fisnik Kruja, kryetar i Forumit Mysliman te Shqiperise.

Ne shkrimet e sipercituara gazetari shkruan ne veten e pare numri njejes, dhe shpreh mendime, aresyetime dhe arrin ne konkluzione te vetat teresisht personale.

Ne baze te Ligjit "Per Shtypin" , shtypi është i lire dhe liria e tij mbrohet me ligj.Ne shkrimet e mesiperme behet nje analize dhe nje hulumtim per historine se si besimi mysliiman hyri ne Shqiperi.Arritja ne te tilla konkluzione nga botuesi, menyra si i trajton ato, vertet bien ndesh me fene mysliimane , por ne ligjin "Per Shtypin" mbi te cilin ushtron detyren e tij botuesi percakton se "Detyra publike e shtypit eshte përmbushja e një



detyrë publike, nëpërmjet hulumtimit përgatitjes dhe përhapjes së lajmeve, të prononcimit, të ushtrimit të kritikës apo mënyrave të tjera dhe është faktor ndikues për formimin e mendimit të lirë.

Nga permbajtja shkrimet e botuesit ndikojne negativisht tek besimtaret myslimane, por ato nuk kane efektin e nje ndikimi masiv per nxitjen e urrejtjes , grindjes raciale, nacionale ose fetare, apo te kene vene ne rrezik paqen publike.

Ne keto kushte materiali kallzues i mesiperem nuk mund te regjistrohet si procedim penal dhe per rrjedhoje duhet mosfilluar.

Keshtu bazuar ne nenin 291 e 290 pika 1 germa "ç" te K.Pr.Penale:

V E N D O S A

- 1.Mosfillimin e procedimit penal per kallzimin nr.3864 te vitit 2010, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.
- 2.Te njoftoj me kete vendim te interesuarit te cilet kane te drejten e ankimit ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, brenda pese diteve nga marrja dijani.

PROKURORI

ARBEN QOSJA

